

# BURIMET E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE: PARIMET E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE MJETET NDIHMËSE (VENDIMET GJYQËSORE DHE DOKTRINA)

## *Qerim Qerimi*

### 1. Parimet e përgjithshme të së drejtës

Përmbajtja e parimeve të përgjithshme të së drejtës, të cilës i referohet neni 38(1)(c) i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, është relativisht e paqartë, por kuptimi i përgjithshëm është se ato janë parime, të cilat janë të përbashkëta për sistemet e brendshme ligjore të shteteve ose të pranuar nga shtetet anëtare të bashkësisë botërore në *foro domestico*.

Duke pasur parasysh kufizimet që mund të krijohen vetëm nga traktatet dhe zakoni si burime të së drejtës ndërkombëtare, neni 38(1)(c) mund të shihet si një orientim për Gjykatën për të plotësuar ndonjë zbrazëti në ligj dhe kështu për të parandaluar një *non liquet* (situatë ku nuk ka ligj të aplikueshëm), duke ju referuar parimeve të përgjithshme të së drejtës.

Parimet e përgjithshme janë parime që nuk janë rezultat i praktikës së shteteve, por janë pjesë qenësore e të drejtës. Janë parime të lidhur ngushtë me nocionin e të drejtës. Pra, nuk janë subjekt i një procesi të formimit. Dhe, qoftë edhe në rast se nuk janë të përfshirë ose nuk reflektohen në të drejtën zakonore ose marrëveshjet ndërkombëtare, mund të përdoren si rregulla plotësuese të së drejtës ndërkombëtare.

Sidoqoftë, përtej pranueshmërisë së origjinës dhe ekzistencës së tyre mbi bazën e, ose si rezultat i, parimeve ligjore të sistemeve të brendshme ligjore, përmbajtja dhe shtrirja e tyre mbetet e paqartë dhe e diskutueshme. Përkundër kësaj, ka një qartësi të përgjithshme dhe pajtueshmëri për, e pakta, disa prej parimeve themelore. Kjo qartësi, si në lidhje me parimet përgjithësisht të pranuar, ashtu edhe në lidhje me përmbajtjen e tyre, është arritur, siç mund të vërehet në vijim, përveç përmes zhvillimit të së drejtës kontraktuale dhe zakonore, veçanërisht përmes jurisprudencës së Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Në fakt, një autoritet i fushës së të drejtës ndërkombëtare vjen në përfundimin se, neni 38 nuk kodifikon një rregull të pashkruar ekzistues për parimet e përgjithshme, por synon të krijojë një burim të ri dytësor, i cili që nga ky rast nuk është kundërshtuar më, e i cili i lë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, dhe jo shteteve, të artikulojë ose shpallë parimet relevante.<sup>1</sup> Fakti tjetër është se, në jurisprudencën e Gjykatës, këto parime nuk kanë shërbyer si baza e vetme e një vendimi, por janë përdorur në mbështetje të vendimeve të cilat është arritur përmes një shumëllojshmërie të burimeve.<sup>2</sup>

Një shembull i këtij parimi është *pacta sunt servanda*; pra, se kontratat/marrëveshjet duhet të respektohen ose premtimet duhet të mbahen, apo në gjuhën e Konventës së Vjenës për të Drejtën

<sup>1</sup> ANTONIO CASSESE, INTERNATIONAL LAW IN A DIVIDED WORLD 171-172 (1986).

<sup>2</sup> IAN BROWNLIE, PRINCIPLES OF PUBLIC INTERNATIONAL LAW 16 (5<sup>th</sup> ed., 1999). Brownlie e citon si të preferueshme pikëpamjen e Oppenheim-it se ideja është për t'i lejuar Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë aplikimin e "parimeve të përgjithshme të jurisprudencës lokale" për aq sa ato janë të aplikueshme në marrëdhëniet mes shteteve.

e Traktateve, “çdo traktat në fuqi është detyrues për palët në të.”<sup>3</sup> Ky parim është qendror për të drejtën ndërkombëtare të traktateve dhe një nga parimet më të rëndësishme të së drejtës së sotme ndërkombëtare. Një parim tjetër i rëndësishëm dhe i ndërlidhur me këtë, është parimi i mirëbesimit, përmbajtja e të cilit kërkon zbatimin në mirëbesim të marrëveshjeve (*bona fide*),<sup>4</sup> të cilit Gjykata e Përhershme e Drejtësisë Ndërkombëtare i referohet në rastet e *Zonave të Lira*<sup>5</sup> dhe i cili riafirmohet e zbatohet nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në rastin e *Testeve Nukleare* (Australia dhe Zelanda e Re kundër Francës).<sup>6</sup>

Parim tjetër, gjerësisht i pranuar, ndonëse i aplikuar në fusha specifike, është edhe parimi i drejtshmërisë (*equity*),<sup>7</sup> i afirmuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në rastin *North Sea Continental Shelf*, dhe i aplikuar në një numër vendimesh të tjera për përcaktimin e shtrimit kontinental dhe zonës ekonomike ekskluzive ose të peshkimit; sigurisht, jo si rregull ligjor, por si mjet ose parim për të ndihmuar një zgjidhje të drejtë.<sup>8</sup>

Disa prej parimeve të tjera janë parimi mbi çështjen e gjykuar apo finalitetin e vendimit gjyqësor (*res judicata*), i aplikuar së fundi në rastin e *Gjenocidit*<sup>9</sup>; parimi *clausula rebus sic stantibus* (që lejon mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale për shkak të një ndryshimi thelbësor të rrethanave), i kodifikuar në Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve<sup>10</sup>; parimi i ndalimit të keqpërdorimit të së drejtës, të cilit Gjykata i është referuar në rastet e *Zonave të Lira*<sup>11</sup>; parimi *lex specialis derogat lex generali*<sup>12</sup> (ligji special ka epërsi ndaj ligjit të përgjithshëm) (ose *in toto*

<sup>3</sup> Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve, neni 26.

<sup>4</sup> *Id.*

<sup>5</sup> *Shih Free Zones Case (Second Phase)*, Final Order, PCIJ, Ser. A, No. 24 (193), 12, dhe *Free Zones Case (Merits)*, Ser. A/B, No. 46 (1932) 167.

<sup>6</sup> *Nuclear Tests Cases (Australia v. France; New Zealand v. France)*, fq. 268, respektivisht 473.

<sup>7</sup> *Shih* po ashtu *Diversion of Water from the River Meuse (Netherlands v. Belgium)* P.C.I.J. Reports Series A/B No 70, 76. *Shih gjithashtu* Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Detare të vitit 1982.

<sup>8</sup> *Case Concerning the Continental Shelf (Libyan Arab Jamahiriya/Malta)*, *supra* note 40; *Case Concerning Delimitation of the Maritime Boundary in the Gulf of Maine Area (Canada/United States of America)*, 1984 I.C.J. 246; *Maritime Delimitation in the Area between Greenland and Jan Mayen (Denmark v. Norway)*, 1993 I.C.J. 38.

<sup>9</sup> *Shih Case Concerning the Application of the Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide (Bosnia and Herzegovina v. Serbia and Montenegro)*, 2007 I.C.J. 91, para. 114-140.

<sup>10</sup> *Shih* nenin 62 të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve, i cili përcakton dy raste kur mund të aplikohet parimi. Sipas këtij neni: “1. Një ndryshim thelbësor i rrethanave, të cilat kanë ndodhur në lidhje me ato që ekzistojnë në kohën e përfundimit të një traktati, dhe që nuk ishte parashikuar nga palët nuk mund të konsiderohet si një arsye për pushimin e traktatit ose tërheqjen prej tij me përjashtim të rasteve kur:

a) ekzistenca e këtyre rrethanave përbënte një bazë themelore për pëlqimin e palëve për të qenë të lidhura nga traktati; dhe

b) efekti i ndryshimit transformon radikalisht shtrirjen e detyrimeve në bazë të traktatit që kanë mbetur ende pa u përmbushur.

2. Një ndryshim thelbësor i rrethanave nuk mund të konsiderohet si një arsye për pushimin e veprimit të traktatit ose tërheqjen prej tij:

a) në qoftë se traktati vendos një kufizim; ose

b) në qoftë se ndryshimi thelbësor është rezultat i një shkeljeje nga pala që e paraqet atë ose në lidhje me një detyrim në bazë të traktatit ose në lidhje me çdo detyrim tjetër ndërkombëtar ndaj ndonjë pale tjetër të traktatit.

3. Në qoftë se në bazë të paragrafeve të mësipërme, një palë mund të pretendojë një ndryshim thelbësor të rrethanave si një arsye për pushimin e veprimit të një traktati ose tërheqjen e tij ajo mund ta paraqesë ndryshimin si një arsye për pezullimin e veprimit të traktatit.”

<sup>11</sup> *Shih Free Zones Cases*, *supra* note 52.

*iure genus per speciem derogatur*); *lex posteriori derogat lex priori*<sup>13</sup> (ligji i ri ka epërsi ndaj ligjit të vjetër ose të mëparshëm).

## 2. Vendimet gjyqësore dhe doktrina

Vendimeve të gjykatave ndërkombëtare dhe vendëse, dhe shkrimeve akademike të juristëve të njohur, nuk mund t'u referohemi në mënyrë tipike si burime të së drejtës. Përkufizimi përgjithësisht i pranuar është cilësimi i vendimeve gjyqësore dhe doktrinës përkatëse si mjet për interpretimin apo përcaktimin e rregullave të së drejtës të krijuara nga burimet e tjera. Në gjuhën e nenit 38(1)(d) të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, janë mjete [jo burime] ndihmëse apo subsidiare “për përcaktimin e rregullave të së drejtës.”<sup>14</sup> Pra, si rregull, roli kryesor i vendimeve gjyqësore dhe veçanërisht i doktrinës është në qartësimin e të drejtës.

Në cilindo rast, një shikim më i afërt dhe i ndarë për të dy këto *mjete* (vendimet gjyqësore dhe doktrinën), mund të jetë i dobishëm për të përfutur një kuptim më të plotë dhe të qartë të roleve të tyre respektive, jo krejtësisht identike, në procesin e ligjëbërjes ndërkombëtare.

---

<sup>12</sup> Ideja se e veçantja ose specialja mbizotëron, ose ka përparësi ndaj të përgjithshmes, ka një histori të gjatë në doktrinën ligjore ndërkombëtare. Sipas Hugo Grotius-it, për ato marrëveshje që shihen si të barabarta, “përparësi i duhet dhënë asaj që është më specifike dhe qasjeve që janë më afër temës [subjektit] në fjalë, pasi dispozitat speciale janë zakonisht më efektive sesa ato që janë të përgjithshme.” HUGO GROTIUS, *DE JURE BELLI AC PACIS*. LIBRI TRES. Libri II, sek. XXIX. *Shih po ashtu Legality of the Threat or Use of Nuclear Weapons, supra* note 42, para. 25. Në këtë paragraf, Gjykata diskuton marrëdhënien ndërmjet të drejtave të njeriut të mbrojtura me Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe ligjeve të aplikueshme në konflikte të armatosura. Për ta kuptuar këtë përmes ilustrimit, neni 6 garanton të drejtën se askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga jeta, dhe Gjykata e pranon se, në parim, e drejta për të mos u privuar nga jeta në mënyrë arbitrare aplikohet edhe gjatë konflikteve të armatosura, dhe shton: “Testi se çka paraqet privim arbitrar të jetës, sidoqoftë, pastaj bie brenda përcaktimit nga *lex specialis*-i i aplikueshëm, që do të thotë, nga ligji i aplikueshëm në konflikte të armatosura.” Pra, sipas Gjykatës, “nëse humbja e një jete, përmes përdorimit të një arme të caktuar në fushëbetejë, është për t'u konsideruar privim arbitrar i jetës në kundërshtim me nenin 6 të Paktit mund të vendoset vetëm duke ju referuar ligjit të aplikueshëm në konflikte të armatosura dhe jo duke nxjerrë përfundime nga fjalët e përdorura të vetë Konventës.”

<sup>13</sup> *Shih*, për shembull, nenin 30 të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve, dhe veçanërisht paragrafin 3 të të njëjtit: “1. Të drejtat dhe detyrimet e Shteteve palë në traktatet e njëpasnjëshme me të njëjtin objekt, që i nënshtrohen dispozitave të nenit 103 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, do të caktohen në përputhje me paragrafet e mëposhtëm.

2. Në rastet kur një traktat specifikon se i nënshtrohet, ose nuk duhet të konsiderohet si i papajtueshëm me një traktat më të hershëm ose të mëvonshëm, dispozitat e traktatit tjetër do të mbizotërojnë.

3. Në rastet kur të gjitha palët në një traktat të hershëm janë gjithashtu palë në traktatin e mëvonshëm, por traktati më i hershëm nuk ka pushuar ose nuk është pezulluar së vepruari në bazë të nenit 59, traktati më i hershëm zbatohet vetëm në atë masë që dispozitat e tij janë në pajtim me ato të traktatit të mëvonshëm.

4. Në rastet kur në palët e një traktati të mëvonshëm nuk përfshihen në një traktat më të hershëm:

(a) midis Shteteve Palë në të dy traktatet zbatohet i njëjti rregull si në paragrafin 3;

(b) midis një Shteti Palë në të dy traktatet dhe një Shtet Palë në vetëm një prej tyre, traktati në të cilin janë palë të dy Shtetet do të rregullojë të drejtat dhe detyrimet e tyre reciproke.

5. Paragrafi 4 nuk do të cenojë nenin 41, ose ndonjë çështje të pushimit ose të pezullimit të një traktati në bazë të nenit 60 ose ndonjë çështje të përgjegjësisë e cila mund të ngrihet për një Shtet nga përfundimi ose zbatimi i një traktati, dispozitat e të cilit janë të papajtueshme me detyrimet e tij kundrejt një Shteti tjetër në bazë të një traktati tjetër.”

<sup>14</sup> Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, neni 38, para. 1, pika d.

### **a. Vendimet gjyqësore**

Siç konfirmohet edhe në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, por edhe përtej kësaj, në praktikën e bollshme gjyqësore dhe jashtë-gjyqësore që shkon përtej thjesht tekstit të Statutit, vendimet gjyqësore shihen si dëshmi e besueshme e asaj cila është e drejta e zbatueshme ndërkombëtare, përfshirë përmbajtjen e saj, në një rast të caktuar. Hezitimi për të mos u dhënë vendimeve gjyqësore statusin e burimit të së drejtës përgjithësisht shpjegohet me hezitimin e një numri të shteteve, kryesisht të atyre që i përkasin traditës së të drejtës civile, për t'u dhënë gjykatave pushtet ligjberës më tepër sesa thjesht aplikues dhe interpretues.

Realiteti është se, shpesh, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë u referohet vendimeve të saja të së kaluarës, vendimeve të tribunaleve ndërkombëtare, siç është rasti me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë,<sup>15</sup> dhe publikimeve të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare, të cilat formalisht i ka cilësuar si deklarata autoritative të së drejtës ndërkombëtare. Kjo përveç faktit tashmë të diskutuar që, Gjykata, gjithashtu, u referohet rezolutave të Asamblesë së Përgjithshme si tregues i mundshëm i zakonit ndërkombëtar.

Në kuptim strikt formal, neni 59 i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në lidhje me pushtetin e kësaj Gjykate, parasheh: “Vendimet e Gjykatës nuk kanë forcë detyruese përveç në mes të palëve dhe në lidhje me atë rast të veçantë.”<sup>16</sup> E vërteta, sidoqoftë, është se si Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, ashtu dhe gjykatat e tjera, përpiqen të ndjekin vendimet e tyre të mëparshme për të siguruar një lloj parashikueshmërie, sigurie dhe stabiliteti në zhvillimin dhe funksionimin e të drejtës ndërkombëtare. Sigurisht, kjo më tepër i ngjan doktrinës së precedentëve (*stare decisis*) të sistemin “common law” apo anglo-sakson sesa sistemit të së drejtës civile. Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale është disi më i qartë dhe shprehimor në këtë drejtim, të ndjekjes së vendimeve të mëparshme. Sipas neni 21 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale, Gjykata mund të aplikojë “parimet dhe rregullat e të drejtës ashtu siç janë interpretuar në vendimet e saj të mëparshme.”<sup>17</sup>

Një vrojtim i kujdesshëm çon në përfundimin se, duke interpretuar të drejtën ndërkombëtare, Gjykata Botërore dhe gjykatat e tjera në të vërtetë, në raste të caktuara, *krijojnë* të drejtën më tepër sesa e *përcaktojnë* se cila është e drejta. Ky funksion implicit (formalisht i heshtur) del më i qartë kur aspekte të caktuara të së drejtës së sotme ndërkombëtare analizohen në dritë të vendimeve gjyqësore ose mendimeve këshillëdhënëse të Gjykatës Botërore dhe ndikimit të tyre në të drejtën ndërkombëtare.<sup>18</sup> Sigurisht, veçantia normative e vendimeve gjyqësore, e bën këtë funksion të dallueshëm dhe të pazbatueshëm në rastin e doktrinës juridike.

### **b. Doktrina**

<sup>15</sup> *Shih Case Concerning the Application of the Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide (Bosnia and Herzegovina v. Serbia and Montenegro)*, supra note 9.

<sup>16</sup> Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, neni 59.

<sup>17</sup> Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale, neni 21, para. 2.

<sup>18</sup> *Shih*, për shembull, vendimet kontestimore në rastet *Fisheries* (U.K. v. Norway), 1951 ICJ 116 (1951) dhe *Nottebohm* (Liechtenstein v. Guatemala), 1955 ICJ 4 (1955); dhe mendimet këshillëdhënëse në rastet e *Dëmshtëpërlimit për Dëmet e Shkaktuara në Shërbim të Kombeve të Bashkuara*, 1949 ICJ 174 (1949) dhe *Rezervave ndaj Konventës së Gjenocidit*, 1951 ICJ 15 (1951).

Siç është theksuar tashmë, Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë e cilëson doktrinën, krahas vendimeve gjyqësore, si mjet ndihmës për përcaktimin e rregullave të së drejtës. Duhet vërejtur se, për dallim nga Statuti i GJND-së, Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale (neni 21), nuk përmban ndonjë referencë shprehimore të doktrina. Përkundër kësaj, roli i doktrinës është vlerësuar tradicionalisht si *mjet* i pazëvendësueshëm në zhvillimin e të drejtës ndërkombëtare. Referencat në vijim të një numër i vendimeve gjyqësore dhe mendimeve doktrinare është një tregues i rëndësishëm i këtij roli të doktrinës.

Qysh në vitin 1900, Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara, në rastin e mirënjohur *Paquete Habana*, ka theksuar:

*E Drejta ndërkombëtare është pjesë e të drejtës sonë, dhe duhet të përcaktohet dhe administrohet nga gjykatat e drejtësisë të juridiksionit të duhur ... Për këtë qëllim, kur nuk ka traktat, dhe as akt kontrollues ekzekutiv ose legjislativ apo vendim gjyqësor, atëherë duhet drejtuar të zakonit e kombeve të qytetëruara; dhe si dëshmi e tyre, të punimet e juristëve dhe komentatorëve, të cilët me vite të tëra të punës, kërkimit dhe përvojës, e kanë familjarizuar veten në mënyrë të veçantë me temat që ata i trajtojnë. Këto punime [publikime] përdoren nga tribunalet gjyqësore, jo për spekulimet e autorëve të tyre në lidhje me atë se çfarë duhet të jetë e drejta, por si dëshmi e besuar e asaj se çfarë është e drejta.<sup>19</sup>*

Një rast tjetër me rëndësi, është një vendim i një kohe të përafërt me atë të Gjykatës Supreme të SHBA-së, të një gjykate britanike. Në të vërtetë, është një vendim i Dhomës së Lordëve në rastin *West Rand Central Gold Mining Co. v. The King*, përmbajtja relevante e të cilit është si vijon: "... pikëpamjet e shprehura nga shkrimtarët e ditur të së drejtës ndërkombëtare i kanë bërë në të kaluarën, dhe do t'i bëjnë në të ardhmen, shërbim të vlefshëm krijimit të opinionit përmes të cilit shtrirja e konsensusit të kombeve të qytetëruara zgjerohet."<sup>20</sup>

Në aspektin doktrinar, një autor e përshkruan kështu ndikimin e doktrinës në zhvillimin e të drejtës ndërkombëtare:

"Historikisht, para se të ekzistonte ndonjë praktikë e madhe shtetërore ose precedent gjyqësor, autorët e të drejtës ndërkombëtare mbanin një pozitë të shquar dhe ishte e pamundur që të mos mbështeteshe thellë në shkrimet e Suarezit dhe Gentilit në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, të Grociusit (vëllimi II i *De Jure Belli ac Pacis* i ka fituar atij titullin e "Babait të së Drejtës së Kombeve"), Zouche dhe më vonë Pufendorf-i në shekullin e shtatëmbëdhjetë, dhe të ashtuquajturit "pozitivistët," Bynkershoek, Moser dhe Van Martens, si dhe Vattel-i "Grocian", të shekullit të tetëmbëdhjetë. Qoftë edhe sot, veçanërisht ku e drejta është e paqartë, avokatët para një tribunali, ose këshilltarët ligjorë të një departamenti [ministrie] të punëve të jashtme të një shteti, do t'i referohen herë pas here punës së këtyre shkrimtarëve, të ashtuquajturit "klasikët e të drejtës ndërkombëtare," ndonjë referencat më të shpeshta bëhen të shkrimet bashkëkohore, veçanërisht librat

<sup>19</sup> 175 U.S. 677, 700 (1900).

<sup>20</sup> 2 King's Bench 391, 402 (1905).

mësimorë të Oppenheim-it dhe monografitë dhe punimet për fusha të specializuara të së drejtës ndërkombëtare.”<sup>21</sup>

### **3. *Ex Aequo et Bono***

Neni 38(2) i Statutit, e lejon Gjykatën që të vendosë *ex aequo et bono*, pra mbi bazë të asaj çka është e drejtë dhe e mirë, në rast se palët pajtohen.<sup>22</sup> Sidoqoftë, deri më sot nuk ka pasur asnjë rast kur palët kanë arritur marrëveshje që Gjykata (qoftë ajo e Përhershme apo e sotmja) të vendosë *ex aequo et bono*.

---

<sup>21</sup> D. W. GREIG, INTERNATIONAL LAW 47-48 (2<sup>nd</sup> ed. 1976).

<sup>22</sup> *Shih* nenin 38(2) të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.